



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

UDHËZIM

Nr. 05 . Datë, 15 .07.2015.

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.3, DATË 11.02.2015 “ PËR
PROCEDURËN E KONKURRIMIT TË KANDIDATËVE PËR PROKUROR QË
KANË PUNUAR GJYQJAR, PROKUROR OSE OFICER TË POLICISË
GJYQËSORE”**

Unë Adriatik Llalla, Prokuror i Përgjithshëm, pasi u njoha me problematikat e konstatuara gjatë testimit të kandidatëve për prokurorë, me mendimin e Këshillit të Prokurorisë, bazuar në nenin 8, pika 2, gërma “gj”, neni 20 të ligjit nr.8737, datë 12.02.2001 “*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*”.

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr.3, datë 11.02.2015 “*Për procedurën e konkurrimit të kandidatëve për prokurorë që kanë punuar gjyqtarë, prokurorë ose oficerë të policisë gjyqësore*”, bëhen këto ndryshime:

- I. Në nenin 5 “Vlerësimi i testimit”, ndryshohen pikat 3 e 4 dhe shtohet pika 5 me përmbajtje si më poshtë:

“3. Vlerësimi për testimin me shkrim është maksimumi 80 pikë. Vlerësimi për seancën dëgjimore është maksimumi 20 pikë.

4. Kandidati kualifikohet për të vijuar procedurën konkurruese nëse në përfundim të testimit me shkrim ka marrë minimumi 65 pikë.

5. Në rastet kur asnjë nga kandidatët nuk arrin të marrë 65 pikë në testimin me shkrim, testimi përsëritet brenda një afati prej 10 ditësh”.
- II. Në nenin 10 “Korigjimi i testeve”, në fund të pikës 4 shtohet një fjali me këtë përmbajtje: “Veprimet dokumentohen me procesverbal.”
- III. Paragrafi 5 i nenit 11 “Vlerësimi”, shfuqizohet.

- IV. Me këtë udhëzim të njihen prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë Shqiptare.
- V. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.
- VI. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Prokurorisë Shqiptare.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ADRIATIK LLALLA

